

Democracy & Governance in Albania

Platformat Zgjedhore — Forumi Civil 2005—



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Ky publikim u bë i mundur me mbështetjen e dhënë nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, sipas termave të CA182-A-00-04-00104-00. Opinonet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë US për Zhvillim Ndërkombëtar.



Projekti: Democracy and Governance in Albania

Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute—NDI), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida para Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për të arritur këtë, qytetarët duhet të jenë të organizuar për të shpërqendruar fokusin e qeverisë nga përfitimet personale tek shërbimi ndaj interesit publik e përcaktuar nga publiku. Konsorciumi DGA, duke ngritur mbi eksperiencën e tij në Shqipëri dhe i gatshëm me ide të reja, punon me kolegë shqipëtarë dhe ndërkombëtarë në arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit dhe përpjekjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-t në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin zgjedhor. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe i japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes të qytetarët, demokratizimit të veprimtarive të brëndshme, dhe nxit breza të rinj udhëheqës. Zgjedhjet Shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol të dukshëm dhe të rëndësishëm në rritje të jetës publike.

Forumi Civil

Deri atëherë kur qytetarët të kenë marrë në kohën e duhur, informacionin e saktë për të kuptuar kostot sociale dhe ekonomike të korrupsionit, demokracia nuk do të lulëzojë në Shqipëri. Qytetarët duhet të mësojnë të bashkojnë idetë dhe zërin e tyre nëpërmjet çështjeve organizative dhe iniciativave monitoruese qeveritare. Ata duhet të mësojnë të bëjnë propozime të qarta për qeverinë respektive dhe të mbajnë përgjegjës udhëheqësit e tyre të zgjedhur. Qytetarët duhet të marrin pjesë në proceset zgjedhore në mënyrë të ndershme, dhe nëpërmjet partive politike përfaqësuese dhe transparente, të shpërblejnë ose të dënojnë udhëheqësit politikë bazuar në rezultatet e kaluara dhe programet e ardhshme.

NDI angazhon qytetarët në rrethet e Shkodrës dhe Vlorës nëpërmjet programit të tij, Forumi Civil për të ngritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e qytetarëve për të marrë pjesë, mbështetur, dhe mbajnë përgjegjës zyrtarët qeveritarë. Pasi qytetarët kuptojnë parimet e demokracisë, ata mësojnë metodat monitoruese dhe mbështetëse. Nëpërmjet këtyre mënyrave, qytetarët janë në gjëndje të luajnë rolin e tyre aktivisht dhe efektivisht.

Metodologjia

Në Mars nisi procesi për të zhvilluar platformat zgjedhore për fushatën elektorale 2005. Pyetësi për hartimin e platformës zgjedhore u krijua duke pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e deputetit përkatësisht në fushën e qeverisjes, ekonomisë, infrastrukturës dhe çështjeve sociale. Qytetarë që kanë bashkëpunuar me Forumin Civil për dy dhe më shumë vjet bënë të mundur shpërndarjen e pyetësorit në zonat elektorale Nr.50 (konkretisht në komunitetet: Baldushk, Pezë, Rogozhinë, Sineballaj, Lekaj, Gosë); zona Nr.46 (Petrelë-Mullet); zona Nr.28 (Kënetë, Durrës); zona Nr.25 (Maminas, Durrës).

Për zonën Nr.50 janë shpërndarë dhe plotësuar 461 pyetësorë, për zonën Nr.46 janë shpërndarë dhe plotësuar 130 pyetësorë. Zonën 28 janë shpërndarë dhe plotësuar 203 pyetësorë dhe për zonën 25 janë shpërndarë dhe plotësuar 205 pyetësorë. Për plotësimin e

pyetësorëve u tërhoqën mendimet e qytetarëve votues duke pasur diversitet grupmoshash dhe një shpërndarje të drejtë gjinore.

Nga përpunimi i të dhënave u zgjodhën 5 çështet më të domosdoshme ku duhet të angazhohet deputeti të cilat përbëjnë dhe prioritetet e platformës. Renditja e prioriteteve u bë sipas një vlerësimi në vlera që do të thotë se sa herë është përzgjedhur një alternativë, dhe vlerësimi në gradë që do të thotë renditjen sipas përzgjedhjes. Vlerat e dhëna prioriteteve bazohen në peshat e mëposhtme specifike: 1-shi e ka peshën specifike 5, 2-shi me 4, 3 me 3, 4 me 2, 5 me 1.

Diskutimi i prioriteteve të platformes në debat

Zona Nr. 50

Pas dorëzimit të platformave zonale tek partitë politike, grupi i qytetarëve të zonës elektorale Nr. 50 organizoi debatin publik midis zgjedhësve të zonës dhe kandidatëve për deputet, me qëllim ballafaqimin e prioriteteve të zonës me programet elektorale të kandidatëve. Qytetari Rustem Thartori me përgjegjësinë e moderatorit të debatit drejtoi kandidatëve për deputet (5) pyetje të orientuara rreth platformës zgjedhore të zonës Nr.50.

Zona Nr. 28

Më dt. 14/06/05, 50 qytetarë nga zona elektorale Nr.28 Kënetë, Durrës do marrin pjesë në debatin publik me kandidatët për deputet të zonës së tyre dhe konkretisht: Gazmir Bizhga (PS); Ferdinand Xhaferi (PD/PDR); Leonidha Gjermani (LSI).

Mjet monitorimi

Bazuar në eksperiencën e 2003 të Forumit Civil me platformat e komunitetit, qytetarët do të përdorin Platformën e tyre Zgjedhore 2005 për të monitoruar performancën e deputetëve të tyre të sapo zgjedhur gjatë gjithë kohës së mandatit të tyre.

**NDI FORUMI CIVIL—PLATFORMA ZGJEDHORE 2005
PYETESOR**

Data ___/___/2005

Komuna/Bashkia _____

Qyteti/Fshati _____

Cilat janë çështjet më të domosdoshme, ku duhet të angazhohet deputeti juaj, sipas fushave të mëposhtme?

Zgjidhni vetëm 5 alternativa për çdo kuadrat dhe vendosni:

1. për alternativën më të rëndësishme
2. për të dytën nga rëndësia
3. për të tretën nga rëndësia
4. për të katërtën nga rëndësia
5. për të pestën nga rëndësia

POLITIKA DHE VEPRIME PERSA I PERKET:

Qeverisje	Infrastrukturë	Ekonomi	Çështjet sociale
<input type="checkbox"/> Përkrahje për procesin e buxhetit lokal <input type="checkbox"/> Funksionim më të mirë të zyrës së deputetit për takime periodike me qytetarët <input type="checkbox"/> Mbështet përprojekjet anti-korrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë <input type="checkbox"/> Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve <input type="checkbox"/> Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin <input type="checkbox"/> Deklarimin e pasurisë sipas afatit ligjor <input type="checkbox"/> Përjasje e ligjeve me kriteret e BE-së <input type="checkbox"/> Bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare	<input type="checkbox"/> Investime në rrugë <input type="checkbox"/> Investime në shkolla <input type="checkbox"/> Investime në qendra shëndetësore <input type="checkbox"/> Investime në hekurudhë <input type="checkbox"/> Energji elektrike <input type="checkbox"/> Ujë të pishëm <input type="checkbox"/> Përmirësimi i kushteve të pikave të kalimit të kufirit	<input type="checkbox"/> Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta <input type="checkbox"/> Ndikim për të dhënë kredi <input type="checkbox"/> Ulja e akcizës për naftën <input type="checkbox"/> Uljen e çmimit të farërave për bujqësinë <input type="checkbox"/> Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve <input type="checkbox"/> Kontakte me biznesin e huaj <input type="checkbox"/> Përmirësimin e kushteve për turizmin <input type="checkbox"/> Ndikim për uljen e taksave për biznesin e vogël	<input type="checkbox"/> Përmirësim i shërbimeve shëndetësore <input type="checkbox"/> Ndihmë sociale <input type="checkbox"/> Rritje e pensioneve <input type="checkbox"/> Sigurimet shëndetësore <input type="checkbox"/> Përmirësimi i gjendjes së arsimit <input type="checkbox"/> Afrimi i gjendjes sociale me kriteret e BE-së <input type="checkbox"/> Mbrojtëse për emigrantët <input type="checkbox"/> Trajtim më të mirë të qytetarëve nga ambasadat e huaja

Keni menduar të votoni në zgjedhjet parlamentare 2005?

PO – JO

Dëshironi të jeni vëzhgues i pavaruar në zgjedhjet parlamentare 2005?

PO – JO

Përmbledhja e Rezultateve të Platformave Zgjedhore 2005

	Nr. 25	Nr. 28	Nr. 46	Nr. 50
QEVERISJE				
Perkrahje për procesin e buxhetit lokal	1	3	2	2
Funksionim më i mirë i zyrës së deputetit	2	4	1	1
Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve	3	1	4	3
Mbështet përpjekjet antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë	4			4
Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin	5	5	5	5
Mbështet përpjekjet antikorrupsion		2	3	
INFRASTRUKTURE				
Investime në rrugë	1	3	2	1
Ujë i pijshëm	2	1	5	5
Energji elektrike	3	2	4	3
Investime në qendra shëndetësore	4	4	3	2
Investime në shkolla	5	5	1	4
EKONOMI				
Ndikim për të dhënë kredi	1	2	3	2
Ulja e akcizës për naftën	2		1	1
Ulja e cmimit të farërave për bujqësinë	3		2	3
Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve	4	1		5
Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta	5	3	4	4
Ulja akcizës për naftën		4		
Ndikim për uljen e taksave për biznesin e vogël		5	5	
ÇESHTJET SOCIALE				
Rritje e pensioneve	1	3	1	1
Përmirësim i shërbimeve shëndetësore	2	2	3	2
Ndihmë sociale	3	1	2	3
Politika mbrojtëse për emigrantët	4		5	
Sigurimet shëndetësore	5	5	4	4
Përmirësimi i gjendjes së arsimit		4		5
VOTUES DHE VEZHgues (%)				
Do të votoni në zgjedhjet 2005? (Po)	96	88	76	96
Doni të jeni vëzhgues i pavarur në këto zgjedhje?	16	47	15	46

Deklaratë Shtypi

Për shpërndarje të menjëhershme – 19 May 2005

Qytetarët ngrejnë zërin e tyre

Qytetarët në katër zona përgatitin “platformat zgjedhore” për partitë politike



Qytetarët aktivistë në Shqipërinë qendrore, kanë biseduar me shokët dhe miqtë e tyre, duke përdorur një sondazh të thjeshtë për të krijuar Platformat Zgjedhore në prag të zgjedhjeve të Korrikut. Duke punuar me programin e Forumit Civil të NDI-it, qytetarët janë duke treguar se zëri i tyre është një element kritik për demokracinë shqiptare.

Këtë vit Platformat Zgjedhore ndërtohen mbi një mbështetje të hershme të Forumit Civil, ku në vitin 2003, qytetarët në 38 komunitete përgatitën Platformat e Komunitetit për partitë politike, për zgjedhjet vendore. Gjithashtu, qytetarët përdorën Platformat e Komunitetit si bazë dhe si mjete për debatet e kandidatëve, me anë të të cilave të monitorojnë qeveritë vendore që nga zgjedhjet.

Qytetarët nga zonat 25, 28, 40 dhe 50 kanë përgatitur dhe tashmë janë duke shpërndarë Platformat e tyre Zgjedhore tek selite e partitve politike dhe tek degët vendore. “Ne jemi duke shpërndarë këto platforma në mënyrë që Deputeti të justifikojë besimin tonë,” tha Nikoll Prenga, nga Këneta (Zona 28). “Kjo platformë është një ngushtim i distancës përse i përket mardhënieve deputet-të zgjedhur,” pranoi Life Ckurti.

Në Qershor, qytetarët do të ftojnë kandidatët për të diskutuar direkt shqetësimet e qytetarëve, ashtu siç vepruan në vitin 2003.



Forumit Civil i NDI, i cili punon në Shqipëri që nga viti 2000, tani është pjesë e Programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, që zbatohet nga NDI, IREX, dhe Partnerët-Shqipëri dhe është financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).


FUND

Zona #25

Deputeti aktual: Spartak Braho (PS; tani LSI)

Emri Kandidateve 2005: Emin Barci (PS), Sami Gjergji (PD), Gani Moka (LSI), Hysen Mushketa (LZhK)

Numri Votuese: 32,653 (nga lista e fundit të Ministrisë se Decentralizimi, Maj 2005)



Deklaratë për shtyp

Datë 19 Maj 2005

Në zgjedhjet parlamentare të 2005, ne qytetarët e zonave elektorale Nr. 28 dhe zonës elektorale Nr. 25 do të hedhim votën për kandidatin që do t'i ofrojë zgjidhje më të besueshme prioritetive të platformave tona zgjedhore.

Ne jemi dy grupe qytetarësh votues, të zonës elektorale nr. 28—Kënetë, Durrës, dhe zonës elektorale Nr. 25—Maminas, Manëz, Sukth që kemi hartuar platformat zgjedhore duke përcaktuar çështjet më prioritare të fshatrave, komunave dhe bashkive tona.

203 pyetësorë (hartuar mbi kompetencat e deputetit) të plotësuar nga qytetarët e zonës Nr. 28 dhe 205 pyetësorë të plotësuar nga qytetarët e zonës Nr. 25, nxorën prioritetet sipas fushave: infrastrukturës, ekonomisë, qeverisjes dhe çështjeve sociale. Për ne, përbëjnë shqetësim dhe kërkojnë zgjidhje: përkrahje për buxhetin lokal, marrja e mendimit të qytetarëve për hartimin e ligjeve, ulja e akcizës për naftën, zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve, investimet në rrugë dhe ujë dhe pijshëm, rritja e pensioneve, ndihma sociale.

Më datë 20/05/05, dy grupe qytetarësh përfaqësues të zonës elektorale Nr. 28 dhe të zonës elektorale Nr. 25, do të dorëzojnë dhe prezantojnë platformat zgjedhore tek selitë e partive politike dhe konkretisht: Partia Demokratike, Partia Socialiste, Lëvizja Socialiste për Integrim.

Prej afro 4 vjetësh komunitetet tona kanë marrë pjesë dhe kanë bashkëpunuar me NDI (Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare) dhe Forumin Civil, të mbështetur nga USAID. Qëllimi i prezantimit të platformave zgjedhore tek partitë politike është përfshirja dhe adresimi i çështjeve tona në programet elektorale të kandidatëve.

Për ta bërë publike në media dorëzimin e platformave tona zgjedhore, ju ftojmë të jeni të pranishëm në takimet me përfaqësuesit e partive politike në selitë përkatëse:

Partia Socialiste	ora: 10.00
Partia Demokratike	ora: 11.00
Lëvizja Socialiste për Integrim	ora: 12.00

Për më tepër informacion kontaktoni qytetarët:

Nikoll Prenga—Kënetë, cel: 0682153074
File Barreti—Maminas, cel: 0682805781

ZONA ELEKTORALE Nr. 25 - MAMINAS, SUKTH, MANZE

Numri i pyetësorëve 205

QEVERISJE	VLERA	GRADE
Perkrahje për procesin e buxhetit lokal	500	1
Funksionim më i mirë i zyrës së deputetit	495	2
Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve	454	3
Mbështet përpjekjet antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë	331	4
Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin	246	5
INFRASTRUKTURE	VLERA	GRADE
Investime në rrugë	659	1
Ujë I pijshëm	510	2
Energji elektrike	402	3
Investime në qendra shëndetësore	316	4
Investime në shkolla	259	5
EKONOMI	VLERA	GRADE
Ndikim për të dhënë kredi	504	1
Ulja e akcizës për naftën	486	2
Ulja e cmimit të farërave për bujqësinë	469	3
Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve	255	4
Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta	235	5
CESHTJET SOCIALE	VLERA	GRADE
Rritje e pensioneve	564	1
Përmirësim i shërbimeve shëndetësore	476	2
Ndihmë sociale	418	3
Politika mbrojtëse për emigrantët	249	4
Sigurimet shëndetësore	153	5
VOTUES DHE VEZHgues	NUMRI	PERQINDJA
Do të votoni në zgjedhjet 2005? (Po)	196	96%
Doni të jeni vëzhgues i pavarur në këto zgjedhje?	34	16%

Kur Ramiz Aruci përfaqësues i komuniteti Maminas, prezantoi platformën zgjedhore tek LSI u shpreh: *"Platforma e komunitetit tonë do të shërbejë jo vetëm për të zgjidhur së bashku prioritetet e përcaktuara, por dhe për ta përdorur si formë të re demokratike të komunikimit qytetar - të zgjedhur"*.

Ligor Petro, kryetari i degës së LSI për Durrësin, pasi dëgjoi me interes platformën tha: *"Ne do të shikojmë platformat tuaja dhe së bashku do të diskutojmë në takime me ju, gjatë fushatës sonë, për këto prioritetet"*.


File Barreti gjatë dorëzimit të platformës tek një përfaqësues i PS: *"Në emër të qytetarëve të zonës 25, hartues të kësaj platforme, ne kërkojmë që shqetësimet tona, të shkojnë te kandidati për deputet dhe të zënë vend në programin e tij elektorale"*.

Zona #28

Deputeti aktual: Pëllumb Berisha (PD; tani LZHK)

Emri Kandidateve 2005: Gazmir Bizhga (PS), Ferdinand Xhaferri (PD/PDR), Leonidha Gjermani (LSI), Pëllumb Berisha (LZHK)

Numri i Votuesve: 39,100 (afërsisht nga harta e zonës elektorale 2005 dhe statistika nga Ministria e Decentralizimit, Maj 2005)



ZONA ELEKTORALE Nr. 28—KENETE

Numri i pyetësorëve 203

QEVERISJE	VLERA	GRADE
Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve	600	1
Mbështet përpjekjet antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë	427	2
Përkrahje për procesin e buxhetit lokal	720	3
Funksionim më i mirë i zyrës së deputetit	722	4
Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin	308	5
INFRASTRUKTURE	VLERA	GRADE
Ujë i pijshëm	505	1
Energji elektrike	407	2
Investime në rrugë	420	3
Investime në qendra shëndetësore	783	4
Investime në shkolla	931	5
EKONOMI	VLERA	GRADE
Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve	794	1
Ndikim për të dhënë kredi	788	2
Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta	703	3
Ulja e akcizës për naftën	427	4
Ndikim për uljen e taksave për biznesin e vogël	354	5
ÇESHTJET SOCIALE	VLERA	GRADE
Ndihmë sociale	859	1
Përmirësim i shërbimeve shëndetësore	826	2
Rritje e pensioneve	715	3
Përmirësim i gjendjes së arsimit	367	4
Sigurimet shëndetësore	103	5
VOTUES DHE VEZHgues	NUMRI	PERQINDJA
Do të votoni në zgjedhjet 2005?	179	88%
Doni të jeni vëzhgues i pavarur në këto zgjedhje?	96	47%

Gazmir Bizhga, kandidat i Partisë Socialiste për deputet i zonës Nr.28 pasi morri platformën tha: *"Kjo platformë duhet të kthehet në një marveshje burrërore gentleman-ësh midis komunitetit dhe të zgjedhurve. Kjo platformë është një angazhim si për ne dhe për ju si qytetarë"*.

Pasi komisioni i qytetarëve nga Këneta dorëzoi platformën tek kandidati i Lëvizjes Socialiste për Integrim, z.Leonidha Gërmenji ai u shpreh: *"Vërej se në prioritetet tuaja nuk është çështja e legalizimit - dhe Nikoll Prenga iu përgjigj - nuk e kemi përfshirë, sepse politikisht të gjitha qeveritë e kanë zgjidhur këtë çështje që nga viti 1992"*.

Life Ckurti: *"Ne duam të lidhim kontratën me partitë politike"*.

Nikoll Prenga: *"Besimi qytetar, detyrimi i politikanëve"*.

Zona #46

Deputeti aktual: Hasan Hoxha (PS)

Emri Kandidateve 2005: Durim Lamaj (PS), Pajtim Pello (PSD), Luftim Ahmetaj (PD), Sokol Dervishaj (LSI), Shkelqim Barusha (LZHK)

Numri i Votuesve: 25,739 (nga harta e zonës elektorale dhe Ministria e Decentralizimit, Maj 2005)



PLATFORMA ZGJEDHORE
Zona elektorale Nr. 46

Ne jemi një grup qytetarësh nga komuna Petrelë që bënë pjesë në zonën elektorale Nr. 46. Ne përfaqësojmë një grupim jo partiak ku bëjnë pjesë: qytetarë, fermerë të thjeshtë, mësues, infermierë, banorë të kësaj komune. Ky grupim, është krijuar me vullnet të lirë e të mirë si dhe me përgjegjësinë qytetare për të kontribuar dhe për t'u angazhuar në çështje të përbashkëta të komunitetit tonë. Në funksion të këtyre çështjeve ne kemi kryer aktivitete të tilla si: pjesmarrje në mbledhjet e këshillit të komunës; takime me deputetin e zonës; projekte të përbashkëta komunë-komunitet; pjesëmarrje në dialogjet politikanë-qytetarë. Duke vlerësuar eksperiencën tonë 3-4 vjecare në përmirësimin e komunitetit, vendosëm të krijojmë e të paraqesim Platformën Zgjedhore në prag të zgjedhjeve parlamentare 2005.

QELLIMI YNE:

- Ngushtimi i hendekut ekzistues mes të zgjedhurve dhe qytetarëve.
- Ballafaqim i prioriteteve të platformës me alternativat që paraqet kandidati për deputet.
- Gjithëpërfshirje e të gjitha shtresave në diskutime e ballafaqime me kandidatin për deputet.
- Mundësi për të zgjedhur/votuar kandidatin, që ofron alternativat më të besueshme për zgjidhjen e prioriteteve të komunitetit.
- Bërja pjesë aktive e qytetarëve në marrëdhëniet me të zgjedhurit e në jetën politike.

Për ne është eksperiencia e dytë që hartojmë dhe paraqesim përpara kandidatëve platformat me prioritetet e komunitetit. Kështu, në zgjedhjet lokale të 2003, komuniteti i Petrelës i komunikoi kandidatëve për pushtetin lokal, çështjet më prioritare përmes platformës së komunitetit. Platforma vazhdon të përdoret jo vetëm si dokument për të monitoruar angazhimin e të zgjedhurit, por edhe për përfshirjen e prioriteteve në buxhetin lokal.

Platforma Zgjedhore u hartua duke pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e deputetit. Për hartimin e kësaj platforme, u tërhoqën mendimet e **130 votues** nga zona Nr. 46, nëpërmjet një pyetësoi. Në plotësimin e pyetësorit pati gjithëpërfshirje të zonës (13 komunitete). Pyetësoi është plotësuar nga femra: 60% dhe nga meshkuj: 40%. Moshë mesatare e qytetarëve që kanë plotësuar pyetësorin është: 18-55 vjeç. Pas analizimit me përgjegjësi të të dhënave të këtij pyetësoi, prioritetet e zonës sonë janë si më poshtë:

<p><u>Përsa i përket Qeverisjes</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Funksionim më të mirë të zyrës së deputetit për takime me qytetarët. 2.Përkrahje për procesin e buxhetit lokal. 3.Mbështetje e përpjekjeve antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë. 4.Marrje e mendimit të qytetarëve për hartimin e ligjeve. 5.Të kërkojë zbatimin e ligjit për decentralizimin. 	<p><u>Përsa i përket Ekonomisë</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Ulja e akcizës për naftën. 2.Uljen e cmimit të farërave për bujqësinë. 3.Ndikim për të dhënë kredi. 4.Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta. 5.Ndikim për uljen e taksave për bisnezin e vogël.
<p><u>Përsa i përket Infrastrukturs</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Investime në shkolla. 2. Investime në rrugë. 3. Investime në qendra shëndetësore. 4.Energji elektrike 5.Ujë i pijshëm. 	<p><u>Përsa i përket Çështjeve Sociale</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Rritje e pensioneve. 2.Ndihmë sociale. 3.Përmirësim i shërbimit shëndetësor. 4.Sigurimet shëndetësore. 5.Politika mbrojtëse për emigrantët.

Ne, qytetarët e Petrelës, mendojmë se kontribuojmë në ngritjen e programeve tuaja në dobi të politikave të zhvillimit të komunitetit.

GRUPI QYTETAREVE PETRELE MAJ 2005

ZONA ELEKTORALE Nr. 46 - PETRELE

Numri i pyetësorëve 130

QEVERISJE	VLERA	GRADE
Funksionim më i mirë i zyrës së deputetit	423	1
Përkrahje për procesin e buxhetit lokal	404	2
Mbështet përprojekjet antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë	391	3
Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve	298	4
Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin	204	5
INFRASTRUKTURE	VLERA	GRADE
Investime në shkolla	423	1
Investime në rrugë	414	2
Investime në qendra shëndetësore	392	3
Energji elektrike	328	4
Ujë i pijshëm	291	5
EKONOMI	VLERA	GRADE
Ulja e akcizës për naftën	410	1
Ulja e cmimit të farërave për bujqësinë	400	2
Ndikim për të dhënë kredi	369	3
Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta	285	4
Ndikim për uljen e taksave për biznesin e vogël	207	5
ÇESHTJET SOCIALE	VLERA	GRADE
Rritje e pensioneve	440	1
Ndihmë sociale	411	2
Përmirësim i shërbimeve shëndetësore	318	3
Sigurimet shëndetësore	277	4
Politika mbrojtëse për emigrantët	192	5
VOTUES DHE VEZHgues	NUMRI	PERQINDJA
Do të votoni në zgjedhjet 2005? (Po)	99	76%
Doni të jeni vëzhgues i pavarur në këto zgjedhje?	20	15%


Novruz Ndregjoni, Sekretari i degës së Partisë Tiranë i Lëvizja për Zhvillim Kombëtar - LZHK gjatë dorëzimit të platformës zgjedhore nga komisioni i qytetarëve: " *Ne jemi një lëvizje e madhe dhe bashkë me ju si lëvizje qytetare t'i çojmë gjërat më tej në funksion të zhvillimit të jetës*".

Zona #50

Deputeti aktual: Shpëtim Kateshi (PS)

Emri Kandidateve 2005: Agron Dibra (PS), Luan Skuqi (PD), Ylli Thartori (LSI), Mustafa Harizaj (LZHK)

Numri i Votuesve: 20,656 (nga Ministria e Decentralizimit, Maj 2005)



PLATFORMA ZGJEDHORE
Zona elektorale Nr.50

Ne jemi një grup qytetarësh nga komunat/bashkitë: Rrogozhinë, Baldushk, Sinaballaj, Lekaj, Pezë, të cilat bëjnë pjesë në zonën elektorale #50. Në këtë grup përfshihen: bujq, mësues, infermierë, mekanikë, zooteknikë, shtëpiakë, banorë të këtyre komunave/bashkive. Angazhimi ynë bazohet në pjesëmarrjen e lirë dhe vullnetare të qytetarëve për të përmirësuar jetën në komunitet. Eksperienca jonë shtrihet në një periudhë 3-4 vjeçare me aktivitete si: takime me të zgjedhurit për premtimet elektorale; pjesëmarrje në mbledhjet e këshillave të komunës/bashkisë për buxhetin lokal; projekte të përbashkëta qytetarë – komunë, ku qytetarët kanë dhënë kontributin vullnetar; pjesëmarrje në dialogjet qytetarë – politikanë. Si qytetarë dhe votues të përgjegjshëm në prag të Zgjedhjeve Parlamentare 2005, vendosëm të hartojmë dhe t’ju prezantojmë Platformën tonë Zgjedhore.

QELLIMI YNE:

- Forcimi i urave të komunikimit qytetarë dhe të zgjedhur qendror.
- Bërja pjesë e vendimmarrjes demokratike dhe të hapur për zhvillimin e komunitetit.
- Ballafaqimi i drejtpërdrejtë i prioritetëve tona me alternativat e kandidatit për deputet.
- Gjithpërfshirje e komunitetit në diskutimet me kandidatin për deputet.
- Përdorimi i platformës si një instrument i fuqishëm për të votuar kandidatin më bindës dhe më të besueshëm.

Në zgjedhjet lokale të 2003, në komunat Baldushk, Lekaj, Sinaballaj ne dolëm me Platformat tona të Komunitetit, drejtuar kandidatëve për kryetar komunash dhe partive politike. Në debatet publike me kandidatët, ne drejtuam pyetje se si do të realizoheshin prioritetet tona. Platformat ndihmuan për të vlerësuar dhe hedhur më me seriozitet votën. Gjithashtu, platforma po përdoret si dokument për të monitoruar punën dhe mbajtjen e premtimeve nga të zgjedhurit.

Platforma Zgjedhore 2005, u hartua duke pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Për hartimin e kësaj platforme nëpërmjet një pyetësi, u tërhoqën mendimet e 461 qytetarëve votues duke respektuar një shpërndarje të drejtë gjinore dhe grupmoshash. Pas analizimit me përgjegjësi të të dhënave të këtij pyetësi, prioritetet e zonës sonë janë si më poshtë:

<p><u>Përsa i përket Qeverisjes</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Funkcionim më të mirë të zyrës së deputetit 2. Përkrahje për procesin e buxhetit lokal. 3. Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve. 4. Mbështet përpjekjet antikorrupsion. 5. Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin 	<p><u>Përsa i përket Ekonomisë</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ulja e akcizës për naftën. 2. Ndikim për të dhënë kredi. 3. Ulja e çmimit të farërave për bujqësinë 4. Kontakte me institucione të huaja. 5. Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve.
<p><u>Përsa i përket Infrastrukturës</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Investime në rrugë. 2. Investime në qendra shëndetësore. 3. Energjia elektrike. 4. Investime në shkolla. 5. Uji i pijshëm 	<p><u>Përsa i përket Çështjeve Sociale</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e pensioneve. 2. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore. 3. Ndihma sociale. 4. Sigurimet shëndetësore. 5. Përmirësimi i gjendjes së arsimit.

Ne, qytetarët e zonës Nr.50, mendojmë se kontribuojmë në hartimin e programeve tuaja elektorale konkrete, bazuar në çështjet dhe shqetësimet tona.

MAJ-2005

ZONA ELEKTORALE Nr. 50
RROGOZHINE, SINEBALLAJ, PEZE, BALDUSHK

Numri i pyetësorëve 461

QEVERISJE	VLERA	GRADE
Funksionim më i mirë i zyrës së deputetit	1429	1
Perkrahje për procesin e buxhetit lokal	1404	2
Merr mendimet e qytetarëve për hartimin e ligjeve	1305	3
Mbështet përpjekjet antikorrupsion të shoqërisë civile e të qeverisë	1304	4
Kërkon zbatimin e ligjit për decentralizimin	660	5
INFRASTRUKTURE	VLERA	GRADE
Investime në rrugë	1762	1
Investime në qendra shëndetësore	1340	2
Energji elektrike	1212	3
Investime në shkolla	1143	4
Ujë i pijshëm	1121	5
EKONOMI	VLERA	GRADE
Ulja e akcizës për naftën	1349	1
Ndikim për të dhënë kredi	1331	2
Ulja e cmimit të farërave për bujqësinë	1328	3
Kontakte me institucione të huaja për kredi të buta	1049	4
Zbatimi i ligjit për rritjen e investimeve	884	5
CESHTJET SOCIALE	VLERA	GRADE
Rritje e pensioneve	1573	1
Përmirësim i shërbimeve shëndetësore	1370	2
Ndihmë sociale	1240	3
Sigurimet shëndetësore	847	4
Përmirësim i gjendjes së arsimit	743	5
VOTUES DHE VEZHgues	NUMRI	PERQINDJA
Do të votoni në zgjedhjet 2005? (Po)	443	96
Doni të jeni vëzhgues i pavarur në këto zgjedhje?	215	46

Në një intervistë televizive Rahim Poda, nga Baldushku përcolli këtë mesazh publik: *"Kjo platformë është bërë nga ne qytetarët e zonës Nr. 50 për të ngushtuar hendekun qytetarë-politikanë, për të paraqitur prioritet, për të bashkëpunuar me deputetin".*

Shqipe Kola nga Peza, në momentin e dorëzimit të platformës tek Lëvizja Socialiste për Integrim: *"Kjo platformë është mesazhi i Ne, qytetarëve të zonës Nr. 50, në veçanti i grave, për ju politikanë që të angazhoheni me seriozitet për çështjet tona".*

Ramazani Cullhai qytetar nga Kalushi, Gosë gjatë prezantimit të platformës tek Dashamir Shehi, përfaqësues i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar: *"Kjo platformë është zëri i përbashkët i qytetarëve që u flet politikanëve dhe kërkon alternativa zgjidhjeje për zhvillimin e komunitetit".*

Bashkimi Kushi, qytetar nga Rrogozhina—momenti i dorëzimit të platformës tek Partia Republikane: *"Kjo platformë është një projekt i qytetarëve, por duke punuar së bashku qytetarë – të zgjedhur ne mund ta bëjmë konkrete dhe ta ndryshojmë realitetin".*